

VENDIM
Nr. 10, datë 11.1.2016

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, me numrat rendorë 1220-1302 (një mijë e dyqind e njëzet - një mijë e treqind e dy), shtohet dhe i bashkë-lidhet vendimit në fuqi.

b) Në listën bashkëlidhur vendimit, përmasat e pronave zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët bashkëlidhur këtij vendimi.

Lista përbëhet gjithsej nga 189 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë) fletë.

2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, ministri i Mbrojtjes dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

